



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 18.12.2023

Prot.13 (tremëdhjetë)

Protokoll nr. 13

I mbajtur sot më datë 18.12.2023, në mbledhjen jashtë radhe të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend dite:

- 1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës)
- 2.P-V “Mbi detajimin e fondeve për pagesë detyrimesh”;

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari; Petrit Kupe; Rudina Bregu; Floreta Zaçe; Ronaldo Skënderi; Eriseld Jonusllari;Pranvera Begolli;Gentiana Drabo; Enida Avdolli; Dritan Çami; Aramando Dautllari; Marianthi Avrami; Xhuana Hoxhallari;Danjela Ibrahim; Plator Çollaku; Klea Baçi; Rovena Terolli;Andonaq Risto; Aleksandra Spaho; Idlir Limllari; 20 (njëzetë) këshilltarë.

Të pranishëm nga Administrata: Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu.

Ornildi Demollari:Fillojmë?Përshëndetje! Kemi thirrur këtë mbledhje jashtë radhe, me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë dhe në mbështetje të ligjit 139/2015, me rend dite, Mbi detajimin e fondeve për pagesë detyrimesh.Ju falenderoj për pjesmarjen, verifikojmë korumin, jemi diku te 18-19 Këshilltarë (shkon 20 numri), realizohet korumi.Ju ftoj të miratojmë rendin e ditës.

Kush është dakord me rendin e ditës ? 20 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstenim? Nuk ka

Miratohet 20 vota pro. Faleminderit!

Ornildi Demollari:Ka ndonjë pyetje për P-V?

Petrit Kupe:Ne si Komision i Financës dhe Ekonomisë e kemi parë këtë P-V, të cilin e mbështetim totalisht, sepse është një transfertë që jepet nga qeveria në kuadër të mbështetjes dhe të forcimit të financave të pushtetit lokal, kjo do e bëjë më të mundur buxhetin e këtij viti për investime, sepse një pjesë e borxhit do shlyhet nga kjo transfertë, por kërkojmë që për vitin e ardhshëm në buxhetin që vjen, rritja e transfertës apo rritja e të ardhruave që parshikohen,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

mendojmë të shlyhen të gjitha detyrimet e krijuara gjatë vitit 2022, ky është një sygjërim që i bëjmë parshikimit të buxhetit i cili duhet të ketë parasysh. Kemi dhe një sygjërim për detyrimet e prapambetura të ish Kombinatit të Sheqerit Maliq sh.a, të mendohet për buxhetin e vitit 2023 të parashikohet një zë i veçantë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të ish Kombinatit të Sheqerit Maliq sh.a, këto kishim ne si Komision.

Ornildi Demollari:Faleminderti! Ka diçka tjetër?

Pranvera Begolli:Në material thuhet të miratohet Raporti i Likujdimet të shoqërisë Klubi i Futbollit, por nuk ka raport!

Kryetari i Bashkisë; z. Gëzim Topçiu:Përshëndetje! E kalojmë për miratim në mbledhjen tjetër, ju falendetoj që e gjetët mundësinë të jeni prezent në një mbledhje jashtë radhe, doja të ndaja dy momente me ju, përveç pikës e rendit të ditës, të ndajmë dhe datën e mbledhjes të buxhetit të vitit 2024, sipas ligjit afati fundit është data 25, po kjo datë përkon me festë, të lemë datën 26, mbledhjen mund ta kishim bërë më parë por çelja e fondit që na u bë me aktin normativ të qeverisë, na i përmbysi një pjesë të shifrave, e ripunuam buxhetin dhe u detyruam të punojmë dhe disa ditë. Të kërkoja mikuptimin e Këshilltarve që ta përcaktojmë që sot ditë, data 26 dita e Martë, besoj se është më e pranushmja dhe në kufij të limitit ligjor. Në lidhje me P-V që ju paraqisim, ashtu si tha dhe Kryetari i Komisionit të Financave, ky është një lehtësim që na bëhet në buxhet, është një Akt-Normativ që tashmë qeveria e kam miratuar për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, janë detyrime në investime dhe 602 për një pjesë. Ne tashmë lehtësohemi nga bara e investimeve të cilat i kemi bërë ndër vite. Ajo çka unë dua tju bëj me dije se këto borxhe janë akumuluar dhe për shkak të punëve të shumta që kemi bërë. Në një farë mënyre kur merr hua detyrohesh të punosh më shumë, të dyja rastet kanë të mira dhe të këqija, por ne kemi menduar të ecim në këtë linjë, kjo na bën ti kërkojmë më shumë qeverisë për transfertën e pakushtëzuar, kështu fondi prej 43.5 milion lekë, një fond i konsiderueshëm, për herë të parë ndodh që na japin fonde të tilla, na bën të shlyejmë të gjithë detyrimet e vitit 2022 dhe një pjesë të vitit 2023 dhe pjesën tjetër e kemi të planifikuar për vitin 2024 dhe për investime të tjera që do ja u bëjmë të diktur në mbledhjen e radhës të këshillit, zërat i keni në emërtesë dhe vlerë, janë zëra të ulur në limitet e mundshme. Nëse ka pyetje konkrete, në lidhje me sygjërimet, ashtu si na detyron ligji në buxhet të hedhim të gjithë detyrimet e prapambetura dhe pastaj të ecim me investime të reja. Në lidhje me Kombinatin e Sheqerit edhe pse është një ndërmarje apo sh.a në vartësi nga bashkia ato janë detyrime ndër vite, nuk është detyrimi i bashkisë, ju nuk duhet të shpenzoni lekë më shumë se mundësia, ne marrim objekte me qira te ju dhe ja u paguajmë qiranë, për këtë punë jepen aktivitete ekonomike me qira për të mbuluar shpenzimet, ne nuk mund të mbulojmë ndërmarje që dalin me humbje, pavarësisht kësaj ne në buxhet të bëjmë një kompesim të asaj çfarë janë detyrime ndaj tatimeve, ju duhet ta mendoni vetë si të dilni nga kjo situatë dhe e fundit nëse ju se pashë pak materialin që keni dërguar, ju duhet të bëni një propozim për Asamblenë ose Këshillin të shfuqizohen anëtarët e Këshillit Mbikqyrës ,të paguhet vetëm ditën kur kanë mbledhje, kjo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

duhet zgjidhur ligjërisht, të saktëohet në Ministri dhe me mbylljen e detyrimeve që kemi, patjetër që shoqërinë do e nxjerrim në likuidim. Klubi i Futbollit është ndryshe, sepse ky klub është krijuar nga bashkia, kombinati nuk është krijuar nga bashkia, ne Klubit të Futbollit nuk i kemi lenë borxhe asnjëherë, ne po bëjmë të pamundurën tju sjellim në buxhet një kompesim për Kombinatin e Sheqerit, por dhe ju Pranvera duhet të bëni një analizë të hollësishme duke i sjellë propozime konkrete Asamblesë apo Këshillit për ato shpenzime që duhen ndaluar. Detyrimet ndaj Këshillit Mbikqyrës ndër vite nuk e kemi, ju duhet ta kishit menduar me ato të ardhura, të kishit sjellë propozime konkrete nga ju. Do doja të kalonim P-V për të cilin jemi mbledhur dhe nëse ka diskutime për këtë jemi të hapur. Në lidhje me zgjedhjet e pleqësive të fshatrave.

Aleksandra Spaho: Si anëtare e Komisionit, dua të bëj një vëretje apo sygjerim material të ishte më i plotë, do e miratoj sot P-V.

Kryetari i Bashkisë; z. Gëzim Topçiu: Në material nuk ke çfarë shpjegon se duhet të marrësh objektet me rradhë, këto janë investime, të miratuara prej jush në buxhetin e një viti më parë apo të tetë viti dhe për mungesë fondesh, nuk janë shlyer. Qeveria ju ka dhënë të gjithë bashkive që kanë borxhe, patjetër që mund të ishte pak më i shtjelluar si material, janë borxhe të mbartuara që duhen shlyer, falenderojmë qeverinë që na ka lehtësuar dhe për buxhetin që vjen.

Andonaj Risto: Shqetëim tjetër, është dhe cilësia e punve që bëjnë firmat e ndërtimit, cilësia është e dobët. Nuk e di a do ketë përgjegjësi për këtë?

Kryetari i Bashkisë; z. Gëzim Topçiu: Në lidhje me ndjken e punimeve, ka një mbikqyrës dhe kolaudator ligjor që kanë me licensë nga shteti dhe ne paralelisht ngrejmë komisioni që mbikqyrin volumet dhe zërat, më shumë shqetësimi ka të bëjë me afatet e zbatimit, ka firma që ka mungesa në pagesë, por ne ligjin nuk e ndryshojmë dot. Nëse një operator ekonomike e fiton me vlerë të ulët ne nuk e skualifikojmë dot, sepse ai i plotëson kriteret, pastaj në ndjekje asim vështirësi, shpresojmë me ndryshimin e ligjit për prokurimit publike ta zgjidhë përfundimisht, që subjektet që nuk janë karkete të skualifikohen.

Rudina Bregu: E kam dhe diçka lidhur me detyrimin e mbetjeve të përziera, do shlyhen detyrimet, që dhe mos ndërpritet pastrimi?

Kryetari i Bashkisë; z. Gëzim Topçiu: Po patjetër, janë të parshikuara sipas radhës.

Ornildi Demollari: Ju lutem , e kalojmë në votim P-V? “Mbi detajimin e fondeve për pagesë detyrimesh”

Kush është dakord ? 20 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstënim? Nuk ka

Miratohet 20 vota pro. Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ornildi Demollari: Do kërkoja mirkuptimin tuaj se nuk ja u thashë në fillim, që në këtë mbledhje të diskutojmë me çështjen e Strukturave Komunitare në fshat, ne kemi mbyllur procesin e zgjedhjeve në pjesën më të madhe të fshatrave dhe kishin ngelur vetëm gjashtë fshatra, për të cilat Kryesia e Këshillit vendosi dy data 16-17 Nëntor për tu zhvilluar zgjedhjet në këto fshatra. Në këto dy data janë zhvilluar zgjedhjet në katër fshatra, përkatësisht në Bickë-Gjyras, Goçë, Plovisht dhe Desmirë Nj.A Gorë, për fshatrat Zvezdë dhe Drithas poshtë ne si Kryesi ramë dakord ta shtyjmë dhe me pak ditë procesin e zgjedhjeve, sepse kemi patur disa paqartësi, të tipit PD ka sjellë propozim një kandidaturë që nuk është banor ai atij fshati, me dakortësinë e mazhorancës dhe opozitës menduam që kjo çështja e Dritashit poshtë të diskutohet në Komisionin përaktës të Këshillit, pastaj çfarë do vendosë Komisioni, ndoshta, shkojmë I drejtojmë një kërkesë Ministrisë së Brendshme ose Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile të na japë ajo një sygjërim si do veprojmë për këtë fshat, ndërsa për Zvezdën, kemi patur një kandidat që ka depozituar kërkesën për dorëheqje, por pas disa ditësh ka erdhur ka depozituar kërkesën, përsëri për të kandiduar dhe duhet ta qartësojmë dhe këtë situatë. Sot do kërkoja nga ju mirkuptimin për të miratuar procesin e zgjedhjeve në katër fshatra përkatësisht: në Bickë-Gjyras, Goçë, Plovisht Maliq dhe Desmirë Nj.A Gorë.

Bickë-Gjyras Z.Niko Demollari, Goçë Z.Mitat Firanj ,Plovisht Z.Ervin Kita- Njësia Administrative Gorë Desmirë Z.Zenel Dinoshi

Kryetari i Bashkisë; z.Gëzim Topçiu: Nuk e di pse po ndodh kjo situatë, do doja që pjesa e anëtarëve të Këshilli që janë marrë me këtë punë të paraqitin në Këshill nga një raport me shkrim, në mbledhjen e radhës. Në lidhje me Dritash poshtë ne nuk kemi fshat, do doja që për këtë fshat Këshilli apo Bashkia ti drejtohet Ministrisë së Brendshme, duke i kërkuar një sqarim ligjor si veprohet, nuk mund të ndodhë që politikisht të shkatrojmë një proces, pra do kërkoj unë dhe ju si Këshill ti drejtohem Ministrisë së Brendshme me një kërkesë duke sqaruar situatën si është, kemi qendër me kaq banorë, nuk është fshat më vete, sepse kjo ndarje bëhet vetëm e me vendim Parlamenti, por flasim për një komunitet të madh, a mund të organizojë Këshilli zgjedhje, pastaj brenda listës së votuesve të bëhen zgjedhje sepse këtë e parashikon ligji, procesi le të shtyhet edhe disa muaj, për fshatin Zvezdë anëtarët e Këshillit përaktës të japin një informacion dhe mbi bazë të tyre të vendoset.

Petrit Kupe: Dua të shpreh për Dritashin, ky problem ka qenë prej vitesh, Ministria e Brendshme nuk e njeh si fshat dhe nuk të jep dakortësinë të vendosësh Kryetar fshati, të zgjidhet një banor i fshatit, Ministria nuk e miraton ligjërisht.

Ornildi Demollari: Ta marrim opinionin nga Minsitria.

Rudina Bregu: Përderi sa nuk e njeh Minsitria, zgjedhjet atje janë bërë të jetë Kryetar fshati ai që është zgjedhur në Dritash lart, të jetë për të dy fshatrat. Ka dy momente nëse bëhet fshat më vete do bëhet procesi me kandidatura ose të lemë Kryetar fshati ai që është zgjedhur në Dritash lart që ka dhe vulën.

Petrit Kupe: Ai është një fshat i madh dhe duhet të zgjidhet Kryetar fshati.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ornildi Demollari:Dakord! Faleminderit! Le të presim një konfirmim nga Institucionet përraktëse, pastaj vijojmë me zgjedhjet.

Aleksandra Spaho:Në fshatin Zvezdë të vendoset emër tjetër, nëse nuk i lejohet atij që ka dhënë dorëhqejen, ne kemi marrë vendim që në Drithas poshtë të ketë Kryetar fshati, ti jepet përgjigje zotërisë dhe PD pse nuk mund të jetë kandidat dhe pastaj PD kalon në instanca të tjera.

Ornildi Demollari:Dakord! Ne kemi paqartësi prandaj do i drejtohem i Minisrtisë.

Pranvera Begolli:Kryetar u vendos që do marrim këto dy vendime.

Kryetari i Bashkisë; z.Gëzim Topçiu:Duhet të jemi koretë ligjërisht, mund të jetë dhe Institucioni i Prefekturës që mund ti drejtohem i, duhet të zgjedhim një përfaqësues në atë fshat së është komunitet i madh, si do që të jetë me vulë pa vulë.Mos kemi predentime për shkelje ligji pas zgjedhjeve nga opozita ose palë të tjera.Ti jepet e drejta ligjore Këshillit të organizojë zgjedhje, pastaj kriteret do i zbatojmë patjetër.

Ornildi Demollari:Dakord! E kalojmë në votim P-V me katër Kryetarët e zgjedhur Bickë-Gjyras, Goçë, Plovisht Maliq dhe Desmirë Nj.A Gorë?

Kush është dakord ? 20 vota pro

Kundra? Nuk ka

Abstënim? Nuk ka

Miratohet 20 vota pro. Punë të mabrë, për dy fshatrat e tjerë do marrim kohë të caktuar deri sa të na vijë opinion i ligjor nga Minsitria dhe pas raportit që do përgatisin grupet për fshatin Zvezdë.Faleminderit!

Ornildi Demollari:Faleminderit! Kjo ishte mbledhja për sot.

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRTI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

